



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 144, Datë 28.08.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MATEO & CO” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MURASI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, NË LUMIN E CEMIT TË SELCËS, DEGË E LUMIT CEM I BASHKUR, NË BASHKINË MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 10 pika 3 dhe nenit 11 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.08.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/3 Prot, datë 25.08.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “MATEO&CO” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1053 Prot, datë 14.08.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë QKB-së në datën 20.05.2016, konform Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar. Në objekt të veprimtarisë së saj shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k ka prodhimin e energjisë elektrike.
- Në vijim të depozitimit të kërkesës për aplikim, shoqëria ka dërguar në ERE shkresën e protokolluar me nr.1053/1 prot., datë 20.08.2020, bashkëlidhur së cilës ka depozituar dokumentacion për qëllime të këtij aplikimi.
- Kontrata nr. 1768 REP., nr. 784/3 KOL., datë 26.07.2017, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Murasi” me kapacitet prodhues 2 MW, në

lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkur, në Bashkinë Malësi e Madhe, Qarku Shkodër, e lidhur midis MIE-s dhe Mbajtësit të Miratimit, aplikuesit “MATEO & CO” sh.p.k, ka një afat 49-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi, me të drejtë ripërsëritjeje.

- MIE ka dhënë për këtë projekt, Miratimin Përfundimtar nr. 3719/13, datë 13.07.2017, “Për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Murasi”, në lumin e Cemit të Selcës, Qarku Shkodër”).
- Shoqëria ka paraqitur Urdhërin e Ministrit të Mjedisit nr. 116, datë 14.04.2017, “Për vijimin e procedurave për heqje nga fondi pyjor kullosor publik të një sipërfaqeje prej 0.1398 Ha në funksion të ndërtimit të HEC “Murasi 1 dhe 2”, në kaskadën e lumit “Cemi i Selcës”, nga shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., në Bashkinë Malësi e Madhe”.
- Shoqëria ka depozituar kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik.”, me nr. 2299 prot., datë 01.06.2017, të nënshkruar midis Bashkisë Malësi e Madhe, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit. Afati i kësaj kontrate ka qenë 1-vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj (01.06.2017).
- Aplikuesi ka depozituar dhe kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik”, me nr. 6418 prot., datë 08.10.2018, të nënshkruar midis Bashkisë Malësi e Madhe, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k në cilësinë e qiramarrësit, me afat 5-vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj.
- Shoqëria ka depozituar dhe vërtetimet në dokument hipotekor të lëshuar nga ZVRPP Malësi e Madhe, datë 29.05.2017, që korrespondojnë me zonën ku do të shtrihet projekti.
- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., ka përcjellë në ERE shkresën e OSHEE sh.a. 27446/2 prot., datë 21.11.2016, “Miratim pikë lidhje”, drejtuar shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., ku përcaktohet se HEC-i, do të lidhet me rrjetin shpërndarës në linjës 35 kv, të n/stacionit Tamarë.
- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujor” me nr. serie 00050, nr. 179/10 prot., datë 20.04.2017, të miratuar nga KBU Drin-Bunë, me vendimin nr. 11, datë 10.04.2017, për shoqërinë “MATEO & CO” sh.p.k. me qëllim ndërtimin e HEC “Murasi”, duke përdorur burimin ujor Lumin Cemi i Selcës, degë e Lumit Cemi i Bashkuar. Në këtë leje citohet se periudha e vlefshmërisë së saj është deri më 09.04.2022. Në këtë leje rekomandohet të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike. Aplikuesi duhet të japë shpjegim në lidhje me kohëzgjatjen e vlefshmërisë së kësaj leje.
- Shoqëria ka paraqitur, VNM Paraprake lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 2829 prot., datë 02.12.2016 dhe nr. 712 Identifikimi dhe nr. 59 Vendimi, për Personin Juridik “MATEO & CO” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin “Ndërtim-operim i HEC “Murasi” me kapacitet 2000 kW.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, apo dokumentacionit të paraqitur jo në formën e parashikuar nga Rregullorja, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

Mungon dokumentacioni që lidhet me parashikimet e Nenit 9 pika 2 gërma “d” (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). Plotësuar pjesërisht. Nga ekstrakti historik i QKB-së i shoqërisë rezulton se selia e shoqërisë është në Shkodër, në vijim do t’i kërkohet që të sjellë vërtetimet e gjendjes gjyqesore te drejtuesve te shoqerise dhe për këtë qark.

- Neni 9, pika 4.1.4 Dokumentacioni tekniko-ekonomik. Gërma c. Oponenca teknike e projektit – Plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka depozituar në ERE në formatin fotokopje, Raportin e Oponencës Teknike të AKBN-së nr. 2572 Prot., datë 20.03.2017, mbi projektin e zbatimit të HEC-it “Muras” miratuar nga MEI me Miratimin Përfundimtar nr. 3719/13, datë 13.07.2017, “Për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Murasi”, në lumin e Cemit të Selcës, Qarku Shkodër”). Do t’i kërkohet shoqërisë që ta depozitojë atë të noterizuar/njësuar me origjinalin.

Për gjithë sa më sipër do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Murasi”, me kapacitet prodhues 2 MW, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, Qarku Shkodër, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**